



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 27.07.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,**  
**BASHKIA POGRADEC**

Në mbështetje të neneve 7, 20 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec Nr.126, datë 06.11.2020 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Pogradec”, me propozimin e Bashkisë Pogradec, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**


1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Pogradec pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
  - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
  - b) Plani i Zhvillimit të Territorit;
  - c) Rregullorja e Planit;
  - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
  - e) Materiali hartografik:
    - i. Vizioni strategjik;
    - ii. Sistemet territoriale të propozuara;
    - iii. Ndarja e territorit në zona dhe njësi;
    - iv. Përdorimi i propozuar i tokës;
    - v. Infrastruktura e transportit;
    - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Në Zonat e Rëndësisë Kombëtare brenda territorit administrativ të Bashkisë Pogradec, shpallur si të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit, apo me vendime të veçanta, autoriteti

përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara është Këshilli Kombëtar i Territorit

3. Në Zonat e përcaktuara si të Rëndësishme Kombëtare dhe për Objektet e Rëndësishme Kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara në njësitë e qeverisjes vendore, autoriteti përgjegjës për miratimin e Lejeve të Zhvillimit dhe Ndërtimit, është Këshilli Kombëtar i Territorit.
4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Pogradec duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
5. Ngarkohet Bashkia Pogradec për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentat e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Pogradec përfshirë, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:
  - Vendim Nr. 16, datë 20.03.1996 “Për zgjerim të vijës kufizuese të fshatit Udemisht Pogradec”;
  - Vendim Nr. 23, datë 20.03.1996 “Për zgjerim të vijës kufizuese të fshatit Bucimas-Pogradec”;
  - Vendim Nr. 24, datë 20.03.1996 “Për studim urbanistik të zonës Tushemisht-Doganë”;
  - Vendim Nr. 38, datë 24.06.1996 “Për studim urbanistik të fshatit Tushemisht”;
  - Vendim Nr. 40, datë 24.06.1996 “Për shtesë të vijës kufizuese të qytetit Pogradec”;
  - Vendim Nr. 54, datë 23.09.1996 “Për studim urbanistik për shpërnguljen e fshatit Cervenakë – Pogradec”;
  - Vendim Nr. 55, datë 23.09.1996 “Për studim urbanistik të bregut të liqenit të Ohrit në zonën nga “Kampi i pionerëve deri tek pallati i Kryeministrit”;
  - Vendim Nr. 64, datë 14.10.1996 “Për plotësimin e Masterplanit të zonës turistike të bregut të liqenit të Ohrit në zonat Doganë – Tushemisht dhe Tushemisht – Lin, duke përfshirë dhe zonat e kompesimit të ish-pronarëve”;
  - Vendim Nr. 5, datë 04.04.2002 “Për studimin urbanistik pjesor të bregut të liqenit të Pogradecit”;
  - Vendim Nr. 2, datë 19.02.2003 “Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Pogradecit dhe vijën kufizuese të kësaj qendre”;
  - Vendim Nr. 7, datë 03.12.2003 “Për detyrën e projektimit për hartimin e planit të përgjithshëm rregullues të qytetit të Pogradecit”.
  - Vendim Nr. 1, datë 07.05.2005 “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Pogradecit”.



- Vendim Nr. 2, datë 07.05.2005 “Për miratimin e detyrës së projektimit për Masterplanin e zonës turistike Lin– Tushemisht (Pogradec);
  - Vendim Nr. 2, datë 15.06.2005 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Pogradecit”;
  - Vendim Nr. 9, datë 06.07.2010 “Detyrë Projektimi për Masterplanin e zonës turistike Pogradec-Drilon dhe Masterplani i zonës turistike Pogradec-Drilon, Komuna Bucimas, Qarku Korçë”;
7. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 04, datë 03.12.2020 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Pogradec”, shfuqizohet.
  8. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
  9. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
  
**EDI RAMA**

REPUBLICA E SHQIPËRISE  
KESHILLI KOMBËTAR I TERRITOREVE  
HILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR/SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

